



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:119169
Datë: 08.08.2024
Numri i dokumentit: 06031038

Kom.Dh.Shk.II.nr.777/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Faton Bajrami, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit K.R.M. Ambienti Sh.A., me seli në Pejë, kundër debitorit Posta PTK Sh.A., R.K. nga Peja, në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, EP.nr.297/2021 i datës 15.10.2021, me datë 21.11.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Posta PTK Sh.A., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë, EP.nr.297/2021 i datës 15.10.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë, me aktvendimin e atakuar EP.nr.297/2021 i datës 15.10.2021 në dispozitivit të aktvendimit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të përmbarimit Posta PTK Sh.A., i ushtruar kundër Urdhrit për caktimin e Përmbarimit P.nr.350/21 të datës 06.07.2021 të Përmbaruesit Privat Zija Bala në Pejë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori Posta PTK Sh.A., me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovet ankesa e debitorit, të shfuqizohet aktvendimi EP.nr.297/2021 i datës 15.10.2021, dhe të hiqen të gjitha veprimet e ndërmarra.

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesën e debitorit.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori K.R.M. Ambienti Sh.A., me datën 06.07.2021 ka paraqitur propozimin për përmbaremore në bazë të dokumentit të besueshme – Ekstrakti të verifikuar Nr. 22639 për periudhën 31.03.2018 deri me 31.05.2021 në shumën e detyrimit në vlerën prej 171.80€, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e kalimit të afatit deri në pagesën definitive si dhe ka kërkuar të gjitha shpenzimet e përmbaremore nën kërcënimin e përmbaremore të dhunshëm.

Përmbaremore Privat Zija Bala, me seli në Pejë, duke vepruar sipas propozimit për përmbaremore të kreditorit me urdhrin përmbaremore P.nr.350/21 të datës 06.07.2021, e ka lejuar përmbaremoren e propozuar nga kreditori, ndërsa debitorit me datë 23.07.2021, ka ushtruar prapësim duke e kundërshtuar në tërësi si të pabazuar urdhrin mbi caktimin e përmbaremore me arsyetimin se kemi të bëjmë me parashkrim të borxhit sipas nenit 360 të LMD-së, dhe i ka propozuar gjykatës që prapësimin të aprovohet, ndërsa urdhri përmbaremore të shfuqizohet dhe të hiqen të gjitha veprimet e ndërmarra.

Përgjigje në prapësim nuk ka parashtruar pala kreditore.

Gjykata Themelore në Pejë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar EP.nr.297/2021 i datës 15.10.2021, me të cilin e ka refuzuar prapësimin e debitorit i ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr.350/21 të datës 06.07.2021 të lejuar nga përmbaremore Privat Zija Bala, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitivin e të njëjtit.

Në arsyetimin të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës ka gjetur se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozimin për përmbaremoren në bazë të të dokumentit të besueshme – Ekstrakti të verifikuar Nr. 22639 për periudhën 31.03.2018 deri me 31.05.2021, shumën e detyrimit në vlerën prej 171.80€. Ka arsyetuar se për gjykatën Ekstrakti në fjalë në bazë të të cilës përmbaremore privat ka zbatuar përmbaremoren është dokument përmbaremore dhe përbënë bazë juridike për caktimin e përmbaremore ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nge neni 29, pika 1.2 i LPP-së për të qenë të përmbaremore dhe njëkohësisht të përshtatshëm për përmbaremore. Prandaj, gjykata e shkallës së parë si në rastin konkret, ka vendosur duke u bazuar në dispozitat e nenin 29 pika 1.2, 71 dhe 69 par.4 të LPP –së.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbartimore. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se në shkresat e lëndës konstatohet se Ekstrakti të verifikuar Nr. 22639 është dokument përmbartues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbartimi dhe është origjinal, prandaj plotëson kushtet ligjore nga nenin 29, pika 1.2 të LPP-së që përcakton se “ *Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.2. “ ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”, prandaj urdhëri përmbartimor ka mbështetje ligjore.*

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë i vlerësoi edhe pretendimet ankimore të palës kreditore, mirëpo të njëjtat i refuzuar si të pabazuar dhe të pa mbështetura në shkresat e lëndës.

Së këndejmi, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike dhe nuk ka vepruar me shkelje të dispozitave me rastin e vendosjes si në aktvendimin e atakuar.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.777/23, me datë 21.11.2023

Gjyqtari
Faton Bajrami